



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Datë: 12.9.2023

Nr: 772

Ora: 16:30

VENDIM

PËR

**MIRATIMIN E PËRMBAJTJES SË FLETËS SË VOTIMIT PËR KANDIDATËT PËR KRYETAR BASHKIE,
PËR ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR TË BASHKISË KUKËS TË DATËS 24 SHTATOR 2023**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja "n" e 2 dhe nenit 98, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" të ndryshuar, vendimit nr. 8, datë 23.2.2023, të Komisionit Rregullator "Për procedurën e hedhjes së shortit për përcaktimin e renditjes së subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve në fletët e votimit në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore", vendimit nr. 31, datë 29.8.2023, të Komisionit Rregullator "Për miratimin e disa karakteristikave teknike të fletëve të votimit për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 Shtator 2023",

VENDOS:

1. Miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për kryetar bashkie, për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar në Bashkinë Kukës të datës 24 Shtator 2023, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Datë: 12.9.2023 Nr: 772
Ora: 16:30



"Për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për kryetar bashkie, për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës të datës 24 Shtator 2023"



FLETË VOTIMI

Zgjedhjet e Pjeshme për
Kryetarin e Bashkisë
Kukës 24 Shtator 2023

QARQU Kukës
BASHKIA Kukës

ZAZ Nr.
QVN Nr.

KANDIDATËT PËR KRYETAR BASHKIE

shënimi i votuesit

1	 ALBERT BISLIM HALILAJ PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË	PS	
2	 EMRI HAXHI VATA BASHKË FITOJMË	BF	



SPECIMEN 1